

**AKT THEMELIMI**

**I**

**Shoqerise Tregtare Me Pergjegjesi Te Kufizuar  
"WD& I TRICOT" shpk**

Themeluesi qe firmosi me poshte:

**SIMONE MASSERINI** - i datelindjes 17.12.1968 banues ne Firenze Itali, Campi Bisenzio Piazza Palagione 6, identifikuar nga Une Noterja nepermjet kartes identitetit Italiane me nr.AX6275892

Qe ne vijim do te perben **Asamblene e Pergjithshme te Shoqerise.**

Sot me date 10.04.2018 bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin nr.9901 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", vendosen te themelojne Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

**KREU I**

**OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK**

**Neni 1**

**Objekti i Shoqerise**

Shoqeria do te ushtroje veprimtari me objekt:

Fason

Import eksport me pakice dhe shumice

Lavanteri

Hekurosje

**Neni 2**

**Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise**

Ortaku themelues vendos qe shoqerine ta emertojne **"WD& I TRICOT" shpk**

**Selia e shoqerise eshte ne Lagja "Kongresi Elbasanit" Elbasan Shqiperi.**

**Adresa e sakte e selise eshte: Lagja "Kongresi Elbasanit", Rruga "Kozma Naska"**

Elbasan zona kadastrale 8521 , pasuria me nr. 13/81.

**Neni 3**

**Regjimi Juridik**

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi.
2. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e rregjistrimit te saj ne rregjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
3. Shoqeria do te kete vulen e saj.

*MASSERINI SIMONE*

**KREU II**  
**TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA**

**Neni 4**

**Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut.**

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata vetem ne territorin e Shqiperise.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne shoqeri ose ne ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj themeltar dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaket marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vete ose nepermjet perfaqesuesve te tyre.
6. Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

**Neni 5**

**KOHEZGJATJA**

Kohezgjatja e shoqerise eshteme afat 5 vjecar Me te drejte ripertesitje.

**KREU III**

**KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT**

**Neni 6**

**Vlera e kapitalit themeltar te nenshkruar**

Kapitali themeltar i nenshkruar i shoqerise ka nje vlere prej 60.000 Leke (gjashte Dhjete mije ) leke.

**Neni 7**

**Numri i pjeseve te kapitalit themeltar te nenshkruar**

Numri i pjeseve te kapitalit themeltar te nenshkruar eshte 1(nje ).kuote.

**Neni 8**

**Vlera nominale e seciles pjese te kapitalit themeltar te nenshkruar**

Vlera nominale e seciles pjese te kapitalit themeltar te nenshkruar eshte 60.000 leke.

**Neni 9**

**Pjesemarrja ne kapitalin themeltar te nenshkruar**


Pjesemarrja ne kapitalin themeltar te nenshkruar eshte 100 %

**KREU IV**

**ORGANET E SHOQERISE**

**Neni 10**

Vendimet ne shoqeri merren nga Asambleja e Pergjithshme. Keto vendime shenohen ne Librin e Shoqerise. Administratori i Shoqerise, eksperti kontabel i autorizuar dhe drejtuesi teknik caktohen nga Asambleja e Pergjithshme.

MASHURINI SIMON 

**KREU V  
ADMINISTRIMI**

**Neni 11**

Administrimi i Shoqerise do te behet ne perputhje me Statutin qe i bashkangjitet ketij Akti.

**KREU VI  
DISPOZITA TE TJERA**

**Neni 12**

1. Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i ndahet Ortakut te shoqerise sipas pjeseve kontribuese ne kapitalin themeltar.
2. Ky akt shtypet dhe firmoset ne kater kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te Shoqerise.

*Administratori dhe ortaku i shoqerise "WD& I TRICOT" shpk*

**SIMONE MASSERINI**

